



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIKA OF  
KOSOVA

AGJENSIONI KOSOVAR KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIA ZA BORBU PROTIV KORUPCIJE NA KOSOVU  
KOSOVO ANTI-CORRUPTION AGENCY



## KONKURS

**Titulli i postit:** Zyrtarë i Lartë për Buxhet dhe Financa  
**Organizata:** Agjensioni Kosovar Kundërkorrupsionit- Departamenti i Administratës  
Divizioni për Shërbime të Përgjithshme  
**Shifra e postit:** DSHA- 4.05  
**Koeficienti i postit:** 8

### Detyrat dhe përgjegjësit:

Zyrtari i Lartë për Buxhet dhe Financa nën udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e Shefit të Divizionit për Shërbime të Përgjithshme, ushtron përgjegjësitë e mëposhtme:

- Raportimin financiar dhe të buxhetit duke përfshirë hartimin e raporteve financiare siç kërkohet me Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe në pajtim me rregullat financiare të Thesarit;
- Mbajtja e llogarive të plota dhe të sakta të të gjitha transaksioneve financiare;
- Siguron plotësimin e të gjitha obligimeve të organizatës buxhetore, duke përfshirë këtu pagesën me kohë të të gjitha faturave për realizimin e procedurave të prokurimit dhe pagesave të tjera në emër të Agjensionit,
- Vendosjen e sistemit informativ dhe procedurave për të monitoruar secilin proces të shpenzimeve (nga inicimi deri te pagesa e faturave) dhe koordinimi i kalimit të urdhrave për zotim e pagesë dhe të dokumenteve të tjera nga zyrtarët autorizues, të Zyrtari i Lartë për Prokurim, certifikuesi dhe deri te Departamenti i Thesarit (në rastet kur kërkohet),
- Siguron se organizata buxhetore do të respektojë të gjitha qarkoret e buxhetit dhe udhëzimet administrative lidhur me hartimin dhe ekzekutimin e buxhetit dhe informimin e Drejtorit për veprimet që kërkohen për ta përgatitur buxhetin;
- Hartimi dhe dorëzimi i projekt-buxhetit të propozuar të organizatës buxhetore dhe kërkesat për ndarje buxhetore;
- Kryen edhe detyra të tjera në pajtim me Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe në pajtim me rregullat financiare të Thesarit dhe detyra të tjera me kërkesën e Drejtorit të Departamentit për Administratë dhe Shefit të Divizionit për Shërbime të Përgjithshme.

### Kualifikimet e nevojshme:

- Kandidati duhet të ketë përgatitje universitare drejtimi në ekonomi, financa, biznes apo të ngjashme ;
- Kandidati duhet të ketë përvojë pune në profesion.
- Kandidati duhet të ketë njohuri të mira në lidhje me buxhetin dhe financat, dhe të parimeve buxhetore.
- Kandidati duhet të ketë njohuri të mira në lidhje me legjislacionin në fuqi dhe
- Kandidati duhet të jetë në gjendje të punojë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti.
- Kandidati duhet të jetë i gatshëm ose e gatshme të punojë jashtë orarit nëse është e nevojshme,
- Të jetë banor i përhershëm i Kosovës,
- Posedimi i patentë shoferit është i dëshirueshëm,
- Njohja e punës me kompjuter Word-i, Excell-i , interneti, përpunimi i tekstit dhe përgatitja e raporteve buxhetore e prezantimeve janë të domosdoshme,
- Kërkohet njohuri e shkëlqyer e gjuhës shqipe dhe /ose e gjuhës serbe, ndërsa njohja e gjuhës angleze është përparësi.